



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

  
swisscontact



Promovimi i punësimit në sektorin privat  
(*ang. Promoting Private Sector Employment*)

PPSE - Kosovë

Raporti gjashtëmuor 2018  
16 Nëntor 2017 - 30 Qershor 2018

Prishtinë,

Në bashkëpunim me:



## Përmbajtja

1. Informata themelore.....	4
2. Përmbledhja ekzekutive .....	5
3. Raportimi arritjes së rezultateve .....	6
3.1. Ndikimi.....	6
3.2 Rezultati 1: Konkurrueshmëria e sektorëve të përzgjedhur .....	7
3.3. Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara .....	11
3.4.1. Fondi i mundësive .....	16
3.4.2. Fondi për përfshirjen sociale .....	17
4. Temat transversale .....	17
4.1. Përfshirja Sociale .....	17
4.2. Gjinia.....	18
5. Konsulenca .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. Financat .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.1. Buxheti.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. Organizimi i projektit, menaxhimi dhe drejtimi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.1. Ngritja e kapaciteteve dhe shkëmbimet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2. Organizimi dhe menaxhimi i projektit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2.1. Drejtimi i projektit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2.2. Monitorimi dhe matja e rezultateve .....	19
7.3 Komunikimi.....	19
8. Mësimet e nxjerra .....	20

## Shkurtesat

BEAM	Ndërtimi i tregjeve efektive dhe të qasshme
BMO	Organizatë e anëtarësimit të biznesit
CHF	Franga zvicerane
DCED	Komiteti i donatorëve për zhvillimin e ndërmarrjeve
DMO	Organizatë për menaxhimin e destinacionit
ENE	Ekonomia dhe punësimi
EYE	Rritja e punësimit të të rinjve
FAMtrip	Udhëtime të familjarizimit
FGD	Diskutim me grupe të fokusuara
FTE	Punësim me orar të plotë
FNI	Ushqimi dhe përbërësit natyral
GAP	Praktikat e mira bujqësore
HO	Zyra qendrore
KIESA	Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Përkrahjes së Ndërmarrjeve
KMC	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
MAP	Bimët medicinale aromatike
MRM	Monitorimi dhe matja e rezultateve
MSD	Zhvillimi i sistemit të tregut
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OC	Rezultat
OF	Fondi i mundësive
PPSE	Promovimi i punësimit në sektorin privat
RAE	Romë, Ashkali and Egjiptian
SC	Komitet drejtues
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SEC	Trupat e ekspertëve seniorë
SGDM	Metodologjia Saint Gallen-it për menaxhimin e destinacionit
SIF	Fondi për përfshirjen sociale
SME	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
SRP	Paneli për shqyrtimin strategjik
ToR	Termet e referencës
YPO	Plani vjetor i veprimit

## 1. Informata themelore

Vendi: Kosovë	Emri i projektit:
SDC No SAP:	Promovimi i punësimit në sektorin privat (PPSE)
Fusha e Strategjisë së Bashkëpunimit: ENE	

Qëllimi	NVM-të që veprojnë në sektorë ekonomikë të mirëorganizuar dhe gjithëpërfshirës, që sigurojnë një rritje të punësimit të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë.
Rezultatet (OC)	<p>Rezultati 1: NVM-të e sektorëve të përzgjedhur rrisin produktivitetin e tyre dhe gjenerojnë të ardhura dhe punësim shtesë.</p> <p>Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, eficientën dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara</p>

Kohëzgjatja e fazës së projektit: 16.11.2017-15.11.2021	Periudha e raportimit: 16.11.2017-30.06.2018
--	---

Buxheti në këtë fazë (CHF) – 7,276,126.50	Buxheti nga 16.11.2017- fund 2018 (CHF) – 2,230,442.50
Buxheti i shpenzuar në këtë fazë (CHF) 953,205.58 (CHF)	
Informacion mbi kontributet e partnerëve dhe/ose donatorëve të tjerë (llogaritur në CHF) 100% SDC	

Organizatrat zbatuese:	Swisscontact dhe Instituti Riinvest
Partnerët kryesorë kombëtarë: Ministria e Tregtisë dhe Industriisë, Odat Ekonomike, firmat kryesore	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë: n/a

Koordinatori i projektit Argjentina Grazhdani	Numri i stafit të projektit 15
Konsulentët ndërkombëtarë (ditët e planifikuara): <sup>1</sup> 25 Konsulentët kombëtarë (ditët e planifikuara): 25 Riinvest (ditë të planifikuara): 57 Swisscontact (ditë të planifikuara): 57	Konsulentët ndërkombëtarë (ditët e ekzekutuara): <sup>2</sup> 4 Konsulentët kombëtarë (ditët e ekzekutuara): 17 Riinvest (ditë të ekzekutuara): 6 Swisscontact (ditë të ekzekutuara): 35

<sup>1</sup> Konsulencia të tjera ndërkombëtare dhe lokale janë planifikuar përmes buxhetit të Pjesës 4 lidhur me vlerësimet dhe intervenimet tek tre Rezultatet e PPSE-së (Shih Shtojcën III).

<sup>2</sup> Konsulencia të tjera ndërkombëtare dhe lokale janë planifikuar përmes buxhetit të Pjesës 4 lidhur me vlerësimet dhe intervenimet tek tre Rezultatet e PPSE-së (Shih Shtojcën III).

## 2. Përmbledhja ekzekutive

Në periudhën e parë të raportimit të fazës së dytë, PPSE u përqendrua kryesisht në ndërhyrjet në masë dhe me potencial të zgjerimit. Në mënyrë të veçantë, për sektorin e ushqimeve dhe përbërësve natyral (së këndejmi FNI; ang. FNI Food and Natural Ingredients), u zbatua intervenimi për promovimin e bujqësisë kontraktuese në 6 rajone të reja me 9 partnerë. Në sektorin e turizmit, intervenimet u përqendruan në rajonet e Prishtinës dhe Prizrenit, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e produkteve të turizmit dhe aktiviteteve të koordinimit të sektorit. Fondi i mundësive (ang. Opportunity Fund), u integrua më tej në kuadër të intervenimeve në sektorë, duke mbështetur projekte të bashkë-investimit me qëllim nxitjen e rritjes së qëndrueshme dhe të zinxhirit të vlerës. Fondi për përfshirjen sociale (ang. Social Inclusion Fund) është një mekanizëm i ri për PPSE-në, i prezantuar në Fazën II për të promovuar barazinë dhe përfshirjen e komuniteteve pakicë të përjashtuara nga shoqëria dhe barazinë dhe përfshirjen e grave.

Edhe pse intervenimet në të dy sektorët pritet të japin rezultate me një vonesë kohore për shkak të sezonalitetit dhe ciklit të prodhimit, në përgjithësi, rezultatet e arritura, që korrespondojnë me periudhën raportuese, janë në përputhje me projeksionet fillestare. Projeksionet për këtë gjashtë mujor janë arritur ose tejkaluar përgjatë shumicës së intervenimeve. Në periudhën raportuese, ndërhyrjet e PPSE-së kanë gjeneruar rreth 235 vende pune ekuivalent me orar të plotë (së këndejmi FTE; ang full-time equivalent jobs FTE), me mbi 635 gra dhe burra që përfitojnë nga punësimi fitimprurës. Përfitimet nga punësimi kanë tejkaluar vlerën prej 1 milion CHF (franga zvicerane), ndërsa rreth 95 NVM kanë regjistruar rreth 340,000 CHF të ardhura neto shtesë.

Një nga fushat kryesore të ndërhyrjes, në fokus të të dy sektorëve, ishte zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe të përmirësuara. Sektori FNI lehtësoi rritjen e prodhimit primar të perimeve dhe bimëve medicinale dhe aromatike përmes bujqësisë së kontraktuar të destinuar për përpunim ose eksport, futjen e prodhuesve të specializuar të fidanëve dhe lehtësimin e programeve të certifikimit për promovimin e eksporteve. Lehtësimi i tregtisë dhe promovimi ndërkombëtar ishte në fokus të të dy sektorëve, ndërsa për sektorin FNI, kjo është bërë përmes ekspozitave në panairë tregtare dhe organizimit të misioneve të shitjes. Nga ana tjetër, sektori i turizmit u përqendrua në organizimin e udhëtimeve të familjarizimit dhe të udhëtimit të gazetarëve, duke synuar veçanërisht tregun e Azisë, si dhe përgatitjen për ekspozita nëpër panairë. Së fundi, sektori i turizmit gjithashtu lehtësoi aktivitete tjera për të përmirësuar organizimin e sektorit në nivel kombëtar dhe lokal.

### 3. Raportimi arritjes së rezultateve

#### 3.1. Ndikimi

NDIKIMI: NVM-i-të që operojnë në sektorë ekonomikë të mirëorganizuar dhe përfshirës, sigurojnë një rritje të punësimit fitimprurës dhe të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë	Treguesi i ndikimit	Vlerësimi bazë <sup>3</sup> 2017	2018 <sup>4</sup> (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	Ndikimi: FTE të punësimit shtesë neto	850 FTEs	T= 500 FTEs A= 235 FTEs	47%	2,000 FTEs	12%
	Punësimi shtesë neto (gratë) FTEs	270 FTEs	T= 150 FTEs A=105 FTEs	70%	600 FTEs	17%
	Punësimi shtesë neto (minoritetet) FTEs	75 FTEs	T= 50 FTEs A=34 FTEs	68%	150 FTEs	22%

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018, ndërhyrjet e PPSE-së kanë krijuar rreth **235 vende pune ekuivalent me orar të plotë**. Ndërhyrjet në sektorin e FNI-së kontribuojnë me gati 90% të këtij rezultati krahasuar me 10% të sektorit të turizmit. Të gjitha rezultatet për treguesit e ndikimit janë në përputhje me rezultatet e parashikuara për këtë gjashtë mujor.

Intervenimet kryesore në sektorin e FNI-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 ishin: **forcimi i sistemit të bujqësisë kontraktuese; mbështetja e lidhjeve për tregti; futja e prodhuesve të specializuar të fidanëve; trajnime për rritje; dhe lehtësimin e programeve të certifikimit**. Deri më sot, rezultatet janë gjeneruar kryesisht nga intervenimet në lidhje me bujqësinë kontraktuese dhe lidhjet tregtare, ndërsa rezultatet e intervenimeve të tjera priten në një fazë të mëvonshme. Për këtë periudhë raportimi, ndërhyrjet në sektorin e FNI-së kanë gjeneruar rreth **211 vende pune të ekuivalent me orar të plotë**, ku shumica e vendeve të punës është krijuara në nivelin e prodhimit primar. Ky rezultat bazohet në vlerësime të azhuruara dhe është përshtatur në bazë të provave në terren nga dëmtimet për shkak të kushteve të pafavorshme të motit. Struktura e punësimit të këtij intervenimi vlerësohet të jetë rreth 48% femra dhe 52% mashkull.<sup>5</sup> **Përfaqësimi i minoriteteve** në punësim ekuivalent me orar të plotë është **16%**. Vlefshmëria dhe zbrëthimi i mëtutjeshëm do të bëhet përmes vlerësimeve të ndikimit (në kohën kur cikli / sezoni përfundon) dhe raportohet me raportin e fundvitit.

Sektori i turizmit lehtësoi ndërhyrjet në lidhje me zhvillimin e produkteve dhe atraksioneve turistike, **promovimin ndërkombëtar**, aktivitetet e koordinimit të sektorit dhe organizimin e **trajnimeve joformale afatshkurtra** për profesionet e turizmit. Janë organizuar aktivitete intensive për promovimin e Kosovës jashtë vendit, veçanërisht në tregjet aziatike, e cila është bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Për më tepër, në tremujorin e parë të vitit, ekipi lehtësoi aktivitete para intervenimeve, përfshirë vlerësimet (p.sh. zhvillimi i produkteve, atraksionet kulturore) dhe përzgjedhjen e partnerëve publikë dhe privatë, të cilat ishin parakusht për zbatimin e intervenimeve. Ndër arritjet kryesore të sektorit ishte futja e aktiviteteve të PPSE-së në turizëm në

<sup>3</sup> Bazuar në arritjet e Fazës I

<sup>4</sup> Kolona paraqet rezultatet e matura brenda raportit të raportimit

<sup>5</sup> Struktura gjinore e punësimit të përfshirë rrjedh në bazë të një mostre të vogël që PPSE ka monitoruar për një studim që lidhet me intervenimin e prezantimit të prodhuesve të specializuar të farërave. Mostra përfaqëson rreth 14% të partneriteteve të përgjithshme të kontraktuara.

komuna të reja, si ajo e Prishtinës dhe Prizrenit, pasi përfshirja e tyre në sektorin e turizmit është ende në një fazë shumë bazike.

Trendët në sektorin e turizmit tregojnë se numri i bizneseve në këtë sektor po rritet, duke rezultuar në më shumë njësi akomodimi, restorante, operatorë turistikë dhe guida. Agjencia e Statistikave<sup>6</sup> të Kosovës tregon se ka **38% më shumë turistë që vizitojnë Kosovën dhe ka një rritje prej 42% të qëndrimeve gjatë natës** në krahasim me një vit më parë. Rezultatet që mund t'i atribuohen intervenimeve të PPSE-së për vitin 2018 është ende herët të vlerësohen për shkak të periudhës jo sezonale, megjithatë, NVM-të përfituese kanë raportuar se kanë krijuar 24 vende të reja pune ekuivalent me orar të plotë (20 meshkuj dhe 4 femra) për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018. Në mënyrë specifike, këto janë punë të reja që lidhen me: shërbimet rreth produkteve të reja (gjithsej 9), guida turistike (gjithsej 7) dhe stafin e mikpritjes (gjithsej 8).

### 3.2 Rezultati 1: Konkurrueshmëria e sektorëve të përzgjedhur

Rezultati 1: Të rinjtë, gratë dhe minoritetet përfitojnë nga punësimi fitimprurës dhe gjithëpërfshirës, i krijuar në NVM dinamike në sektorët në rritje	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OC 1.1 Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga	0	T= 1,250 A= 635	51%	5,000	13%
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (gratë)	0	T= 375 A=282	75%	1,500	19%
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (minoritetet)	0	T= 125 A=149	119%	500	30%
	OC 1.2 Rritja e të ardhurave për 5,000 burra dhe gra përmes pagës / të hyrave	0	T= CHF 2,400,000 A=CHF 1,175,000	49%	CHF 9,600,000	12%

Ndërhyrjet në sektorin e FNI-së kanë krijuar **mundësi punësimi për rreth 600 njerëz**, me një strukturë gjinore të vlerësuar prej **46% femra dhe 54% meshkuj**<sup>7</sup>, dhe me një përfitim të parashikuar prej **970,000 euro rritje të të ardhurave** përmes pagës. Përfaqësimi i minoriteteve në punësimin e krijuar qëndron në rreth 25%. Përveç mundësive të reja të punësimin, ndërhyrjet në lidhje me qasjen në kanalet e reja të shitjes kanë rezultuar në rritje të eksporteve në tregje të reja, ku fermerët ekzistues kanë përfituar drejtpërsëdrejti (eksporti i mjedrave, manaferrave dhe MAP - bimëve medicinale aromatike).

Ndikimi i ndërhyrjeve në sektorin e turizmit dhe fondi i mundësive ka krijuar punësim për të paktën **35 persona të tjerë (29 meshkuj dhe 6 femra)**. Të ardhurat e përgjithshme të personave të punësuar rishtazi janë **61,000 €**. Ekipi ka vërejtur se bizneset e turizmit po rriten vazhdimisht, angazhojnë dhe rrisin numrin e guidave çdo vit, për shkak të të ardhurave më të larta dhe qarkullimit të turistëve që

<sup>6</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-hotelerise-tm1-2018>

<sup>7</sup> Struktura gjinore e punësimin të përfshirë është nxjerrë bazuar në një mostër të vogël që PPSE ka monitoruar për një studim që lidhet me ndërhyrjen e Prezantimit të Prodhuesve të Farërave të Specializuara. Mostra përfaqëson rreth 14% të partneriteteve të përgjithshme të kontraktuara.

mund t'i atribuohen ndërhyrjeve të PPSE-së. Detajet e ndërhyrjeve dhe aktiviteteve që çojnë në rezultate janë paraqitur në detajet e të arriturave përkatëse.

### Të arriturat 1.1:s NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve

Të arriturat 1.1. NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 1.1. Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe të përmirësuara të promovuara përmes NVM-ve	0	T= 38 A=13	34%	150	9%
	OP 1.1.2 Vlera shtesë e investimeve për produktet dhe shërbimet e reja	0	T= CHF 1,250,000 A=CHF 912,000	73%	CHF 5,000,000	18%
	OP 1.1.3 Numri i NVM-ve që ofrojnë produkte dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara	0	T= 25 A=8	32%	100	8%

Sa i përket përmirësimit të cilësisë dhe diversifikimit të produkteve dhe shërbimeve, ekipi i FNI-së po zbaton disa ndërhyrje, aktivitete dhe mekanizma si: platforma e biznesit '**Coaching for Growth**' në partneritet me CEED; përmirësimi i kapaciteteve të NVM-ve përmes ndërhyrjeve dhe Fondit të Mundësive; rritjen për mbështetjen e konsulencës me Recura; dhe misionet e trupave të ekspertëve seniorë (ang. SEC – Senior Expert Corps).

Rreth 28 kompani janë të përfshira në të gjitha ndërhyrjet që priten të rezultojnë në përmirësimin e cilësisë dhe diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve. Deri tani, në treg janë prezantuar/përmirësuar **11 produkte**<sup>8</sup> nëpërmjet ndërhyrjeve të FNI-së, kryesisht produkte në nivelin e prodhimit primar. Megjithatë, rezultatet e mëdha të kësaj të arriture priten në nivelin e përpunimit nëpërmjet ndërhyrjes së "Coaching for Growth". Duke marrë parasysh kohën e nevojshme që kjo ndërhyrje të jep rezultate, këto do të jenë në dispozicion vetëm në fund të vitit. Deri në kohën e këtij raportimi, vlera totale e investimeve shtesë të NVM-ve të përfshira ka arritur rreth **750,000 euro**.

- PPSE ka mbështetur CEED për të prezantuar 'Coaching for Growth', një platformë e re për bizneset me qëllim të mbështetjes së biznesit të regjistruar për të prezantuar produkte të reja dhe për të përmirësuar produktet ekzistuese. Kjo platformë ofron njohuri për ndërtimin, shkëmbimin e informacionit dhe trajnim individual për NVM-të në temat e zhvillimit të produktit. PPSE po subvencionon koston e tarifave të platformës, ku kompanitë aktualisht paguajnë një pagesë të reduktuar. Aktualisht, **17 NVM të përpunimit të ushqimit (3 me**

<sup>8</sup> Këto produkte përfshijnë kultura të reja bujqësore të integruara në bujqësinë e kontraktuar: piper spec djegës, trangull i vogël, kamomil, mente, rigon, fruta goji, fisalis, kungull, luledielli dhe hithër.



**pronësi gra**) janë të regjistruar në program. Për më tepër, platforma ofron tri vizita shkëmbimore lokale dhe rajonale, ku dy vizita janë përfunduar me sukses (vizita në Rugovë dhe Frutomania). Kjo platformë do të vazhdojë të paktën deri në fund të vitit. Përveç kësaj, nëpërmjet një këshilltari me përvojë të biznesit, RECURA, PPSE-ja po lehtëson **shërbimet e konsulencës për Krushën e Madhe** (kooperativa në pronësi të grave) duke synuar mundësi të mëtejshme të rritjes në kuadrin financiar dhe operacional.

- Për të nxitur rritjen e biznesit dhe forcimin e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve kosovare në sektorin e përpunimit të ushqimit, PPSE është duke punuar direkt me NVM-të përmes **misioneve të SEC**. Deri më sot, 4 NVM do të përfitojnë nga Ekspertët e SEC-ut në përmirësimin e produkteve/recetave, cilësisë dhe paketimit të tyre. Një nga këto NVM është me pronësi nga radhët e minoriteteve, me qendër në Graçanicë.
- Përveç kësaj, PPSE po hulumton mundësi për të lehtësuar **shërbimet e teknologjisë ushqimore**. Si shembull, në bashkëpunim me Klubin e Prodhuesve të Kosovës (ang. KMC – Kosovo Manufacturing Club), projekti ka shikuar mundësinë për të bashkëpunuar me Qendrën Industriale të Arsimit Profesional të Bursës (BUTGEM BTSO) në Turqi. Megjithatë, qendra e trajnimit nuk mund të zhvillonte program trajnimi të përshtatshme për nevojat e kompanive kosovare. Mundësitë e tjera po hulumtohen.

Në këtë periudhë raportuese, ndërhyrjet dhe aktivitetet për futjen e produkteve dhe atraksioneve të reja turistike u përqendruan në komunat e Prishtinës dhe Prizrenit që synojnë **segmente kulturore dhe argëtuese turistike**. Pas angazhimit ndërkombëtar për të identifikuar produkte potenciale të turizmit për Kosovën, ekipi ka promovuar investimet në produktet dhe atraksionet turistike dhe është duke i shtyrë partnerët e interesuar të zhvillojnë këto produkte. Kjo është bërë në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat, dhe deri tani ka arritur në procesin e zhvillimit të planit për një **muze të arteve në Prishtinë dhe një qendër për Paragliding në Prizren**. PPSE gjithashtu nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me këto dy komuna për të përmirësuar dhe pasuruar ofertën e turizmit.

Në ndërkohë, produktet që janë zhvilluar në dy vitet e fundit kanë vazhduar të tërheqin një numër në rritje turistësh, duke rritur kështu në më shumë se 50 biznese përfituese. Pronarët ekzistues të produkteve vazhdojnë të zgjerojnë ofertën e tyre, ndërsa gjatë kësaj periudhe raportuese u regjistrua një investim total prej **50,000 €**, dhe katër produkte të reja, dy nga Fondi i Mundësive (qilim për skijim dhe park argëtues në zonën e Bogës, Komuna e Pejës) dhe dy u inicuan (guida me makina të borës dhe shigjetari në Junik dhe Rugovë) në mënyrë të pavarur nga përfituesit e mëparshëm.

- Gjatë ndërhyrjes së **zhvillimit të produkteve të turizmit**, PPSE fillimisht ka autorizuar një vlerësim përmes MDP Consulting (kompani franceze) për të identifikuar produktet turistike dhe atraksionet që mund të zhvillohen në komunat e Prishtinës, Prizrenit dhe në Veri të Kosovës. Raporti i është shpërndarë akterëve privatë dhe publikë, ku u organizuan takime pasuese dhe debate. Deri më sot, është nënshkruar një marrëveshje me **Aeroclub Shkaba dhe Komunën e Prizrenit** për të zhvilluar dhe ofruar **paragliding** në Prizren. Ky produkt pritet të jetë në treg duke filluar nga gushti i vitit 2018. Ekipi momentalisht është duke planifikuar mbështetjen teknike, siç kërkohet nga Komunat e Prishtinës dhe Prizrenit për zhvillimin e tri produkteve (teleferikun në Prizren dhe Prishtinë dhe shtigjet për ecje në Kanionin e Nashecit). Për më tepër, po hulumtohen mundësi për partneritete potenciale me sektorin privat për zhvillimin e më shumë se pesë produkteve të turizmit.
- Nëpërmjet ndërhyrjes në **atraksionet e turizmit**, PPSE synon të përmirësojë ofertën dhe veprimtarinë e atraksioneve si muzetë, objektet fetare dhe vendet arkeologjike. Për të arritur këtë, u krye një studim paraprak, për të kuptuar më mirë situatën ligjore dhe operacionale të atraksioneve kulturore, fetare dhe arkeologjike. Gjetjet e studimit tregojnë një strukturë komplekse ligjore dhe institucionale në lidhje me menaxhimin e këtyre atraksioneve, ku

përgjegjësitë nuk janë të përcaktuara qartë, prandaj edhe pengojnë funksionalizimin efektiv. PPSE po mbështet Komunën e Prishtinës me ekspertizën teknike për të krijuar një muze të ri, Muzeun Ibrahim Kodra. Investimi për këtë muze po bëhet nga Fondacioni 'Ibrahim Kodra' ku komuna ka ofruar lokacionin. Ky muze pritet të hapet deri në fund të vitit. Do të operohet nën një organizim të ri (të udhëhequr nga Komuna e Prishtinës) dhe pritet të shërbejë si një model për atraksionet e tjera ekzistuese dhe të reja. Për më tepër, ekipi i ekspertëve lokalë, të mbështetur nga PPSE, do të mbështesë Komunën e Prishtinës në projekte të tjera si: Strategjia e Turizmit, Muzeu i Arteve Bashkëkohore, Qendra Historike e Prishtinës etj.<sup>9</sup>

### Të arriturat 1.2: NVM-të kanë rritur prodhimin.

Të arriturat 1.2 NVM-të kanë rritur prodhimin	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
OP 1.2.1 Numri i fermave dhe NVM-ve të përfshira në bujqësi kontraktuese		350 SME	T= 250 SME A= 234 SME	93%	1,000 SME	23%
OP 1.2.2 rritja e prodhimit të kontraktuar		200 ha	T= 125 ha A= 363 ha	290%	500 ha	72%

PPSE ka lehtësuar dy ndërhyrje për rritjen e volumit dhe cilësisë së prodhimit primar. **Ndërhyrja e forcimit të sistemit të bujqësisë kontraktuese**, i cili ka për qëllim rritjen dhe përmirësimin e rrjedhjes së prodhimit primar dhe të grumbullimit të produkteve nga niveli i fermës dhe i përshtatur ndaj kërkesave të përpunuesve, pikave të grumbullimit dhe eksportuesve. **Ndërhyrja e prezantimit të prodhuesve të specializuar të farërave** synon të fusë fidanishtet profesionale në Kosovë që ofrojnë fidane cilësore - e cila është një domosdoshmëri për cilësi dhe rendiment më të lartë prodhimi të perimeve dhe MAP-et.

Rreth **234 ferma të tjera** janë të përfshira në prodhimin e kontraktuar përmes ndërhyrjeve të PPSE-së, që paraqet një rritje prej 52% krahasuar me shtrirjen totale të Fazës I. Këto ferma kanë zgjeruar sipërfaqen e prodhimit primar me **363 hektarë** shtesë për të përmbushur nevojat kontraktuale të nëntë përpunuesve partnerë, pikave grumbulluese dhe eksportuesve.

- Ekipi i FNI-së ka zgjeruar ndërhyrjen e **forcimit të sistemit të bujqësisë kontraktuese** në 6 rajone të reja (që mbulojnë Prishtinën, Pejën, Podujevën, Ferizajn, Kaçanikun dhe Skenderajn) dhe me 11 kultura të reja (piper spec djegës, trangull i vogël, kamomil, mente, rigon, fruta goji, fisalis, kungull, luledielli dhe hithër). Deri më sot, **janë nënshkruar 9 marrëveshje partneriteti me përpunuesit, pikat e grumbullimit dhe fidanishtet**. Rezultati i ndërhyrjes në bujqësi kontraktuese është që kontraktorët (p.sh. qendrat e grumbullimit) të përmirësojnë shërbimet siç janë dhënia e lëndës së parë, këshillimi, grumbullimi, mbjellja dhe shërbimet e makinerive të korrjeve për fermerët e kontraktuar. Kjo pritet të çojë në një cilësi më të mirë dhe rritje më të lartë të prodhimit të fermerëve, duke u mundësuar atyre që të përmbushin kërkesat e palëve të kontraktuara.

<sup>9</sup> Ibrahim Kodra ka qenë piktor i famshëm shqiptar, 1918-2006. Disa nga pikturat e tij ruhen në muzeun e Vatikanit, Dhomën e Deputetëve në Parlamentin Italian etj.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë këtij viti, Kosova ka përjetuar kushte të papritura të pafavorshme të motit për bujqësinë të cilat vlerësohet se kanë ulur fitimet dhe prodhimin për rreth 20-30%<sup>10</sup> për kulturat e ndryshme.

- Bazuar në gjetjet e Fazës I në lidhje me mungesën e prodhimit primar për shkak të cilësisë së ulët të fidanëve, PPSE ka mbështetur **prezantimin e prodhuesve të specializuara të farërave** në Kosovë për perimet dhe MAP-et. Nëpërmjet Fondit të Mundësive, ekipi ka vendosur të bashkëfinancojë **krijimin e një fidanishteje moderne të re, përmes një procesi përzgjedhës** me një thirrje për aplikim. Për më tepër, PPSE po mbështet edhe dy fidanishtet ekzistuese, Peppermint International nga Leposaviqi dhe Agroproduct nga Istogu, të dy të angazhuar në nënsektorin e MAP-eve, me kapacitete gjysmë profesionale / tradicionale, një NVM nga pjesëtarët e minoriteteve përmes fondit të mundësive dhe një përmes ndërhyrjeve sektoriale, për të rritur kapacitetet e tyre dhe t'i shpiej drejt fidanishteve më profesionale. Kjo ndërhyrje është e lidhur ngushtë me ndërhyrjen bujqësore të kontraktuar për të integruar prodhimin e fidanëve në sistemin bujqësor të kontraktuar.

### 3.3. Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efijencën dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara

Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efijencën dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OC 2.1 Numri i NVM-ve përfitojnë nga përdorimi i shërbimeve të reja ose të përmirësuara mbështetëse	0	T= 38 SMEs A= 8 SMEs	21%	150 SMEs	5%
	OC 2.2 Rritja shtesë neto e të ardhurave e 150 NVM-ve	0	T= CHF 950,000 A=CHF 341,000	36%	CHF 3,800,000	9%
	OC 2.3 Institucionet janë më të përgjegjshme për rritjen e sektorit privat	0	<i>Vlerësimi cilësor bazuar në diskutimet në grupe të fokusuara të personelit kryesor të institucionit</i>			

Në sektorin FNI, **5 NVM veçse janë duke përfituar nga shërbimet e reja mbështetëse** të cilat janë lehtësuar nga PPSE-ja. Këto shërbime janë kryesisht të ndërlidhura me **lehtësira tregtare dhe promovim të eksportit**, dhe të ofruara nga shoqatat sektoriale si Organika dhe Mjedra e Kosovës. Si rezultat i drejtpërdrejtë i intervenimit të PPSE-së, ndërmarrjet përfituese kanë raportuar të hyra shtesë neto prej **145,000€**.

Në gjysmën e parë të vitit 2018, sektori i turizmit ka lehtësuar futjen e tri shërbimeve të reja mbështetëse në treg. Një shërbim ndërlidhet me lehtësimin tregtar, ku tri ndërmarrje kanë raportuar përfitim, dhe dy janë të ndërlidhura me trajnime jo-formale për profesion turizmi (guida dhe kamerierë). Në anën tjetër, **rreth 80 NVM përfituese nga PPSE** (nga të gjitha intervenimet) kanë raportuar një rritje në të hyrat neto shtesë prej **154,000€**.

<sup>10</sup> Bazuar në vëzhgimet (të dhënat) nga terreni dhe raportet e marra nga partnerët (burimet do të shtohen).

PPSE ka mbështetur Komunën e Prishtinës për të zhvilluar një strategji turizmi të bazuar në **metodologjinë a Saint Gallen-it per menaxhim** përmes një qasje gjithëpërfshirëse të sektorit privat. Komuna e Prizrenit veçse ka shprehur interesim për hartimin e strategjisë së turizmit, duke përdorur metodologjinë e St. Gallen-it. Për më shumë, komunat e Prishtinës dhe të Prizrenit janë zotuar që të ngrisin mbështetjen e tyre financiare për zhvillimin e turizmit, duke filluar nga viti i ardhshëm.

### Të arriturat 2.1: Ofruesit e Shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara

Të arriturat 2.1: Ofruesit e Shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.1.1 Numri i NVM-ve që përdorin shërbime të reja dhe të përmirësuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve	0	T= 75 SMEs A= 53 SMEs	70%	300	18%

Nën këtë të arritur, ekipi i FNI-së, ka mbështetur një intervenim për **lehtësimin e programeve certifikuese**. Brenda këtij intervenimi, NVM-të kanë pasur qasje në dy **programe certifikuese, Organik dhe Global GAP**, përmes BMO-ve sektoriale si Organika dhe Mjedra e Kosovës. Përveç kësaj, NVM-të sektoriale tani kanë qasje në shërbime të reja të lehtësuara përmes intervenimeve të cilat bien nën rezultate tjera. Këto shërbime mbështetëse, përfshijnë lehtësimin tregtar (panaire dhe misione shitjesh nga Organika – e arritura 2.2) dhe shërbime dhe produkte zhvillimore biznesore (stërvitje për rritje nga CEED dhe Recura – e arritura 1.1).

Së bashku, **48 NVM-të nga sektori i ushqimit**, momentalisht janë duke përdorur shërbimet e reja mbështetëse të cilat janë lehtësuar nga PPSE. Një rezultat i rëndësishëm, është ngritja e numrit të aplikuesve të NVM-ve për certifikim organik, si dhe të anëtarësimit të NVM-ve në BMO-të që lehtësojnë programet certifikuese.

- Nën intervenimin **lehtësimi i programeve certifikuese** PPSE-ja është duke lehtësuar *Certifikimin Organik*, ku **28 ndërmarrje (9 për herën e parë)** janë në proces të certifikimit organik, dhe 3 prodhues të boronicës janë në proces për certifikim *Global G.A.P.* Shërbimet për certifikim Organik ofrohen përmes ORGANIKA (Shoqata e sektorit të produkteve pyjore jo-drusore dhe e ndërmarrjeve të MAP-it), nga trupi certifikues Albinspekt nga Shqipëria, përderisa për certifikim Global përmes Mjedra e Kosovës (shoqata e prodhuesve të frutave të buta) nga GAP Plus, nga Kosova. Përveç kësaj, PPSE ka mbështetur Organika-n për të futur një shërbim të ri, në përgatitjen e aplikantëve (anëtarëve të shoqatës), për të qenë në përputhje me certifikimin organik. Qëllimi i intervenimit është që të promovohet certifikimi Organik dhe Global G.A.P, ndërmjet anëtarëve të BMO-ve, gjë e cila do të rrit shitjet dhe të hyrat, dhe qasjen në tregje të reja eksportuese.
- PPSE-ja po e përcjell nga afër Fazën I të intervenimit në **futjen e financimit të kontratave**. Në periudhën raportuese, Banka NLB ka vendosur të fus financimin e kontratave si produkt të ri në treg në prill të vitit 2018, por asnjë kredi nuk është lëshuar deri në këtë periudhë raportuese. Arsye kryesore është që normat e interesit në linjë me produktin janë më të larta se ato të zakonshmet. PPSE-ja do të përcjell NLB-në nëse ka nevojë të ri-dizajnojë produktin.
- Nën **misionin SEC** në Kosovë, **2 NVM shtesë** do të përfitojnë në përmirësimin e shërbimeve të shitjeve dhe të marketingut (1 në pronësi të një gruaje nga grupi i minoriteteve).

- Aktivitete të mëtejshme momentalisht janë duke u hulumtuar nga një ekip, në bashkëpunim me shoqatën shitësve të lëndës së parë të Kosovës (SHTIB) për të përmirësuar shërbimet e informacionit dhe ato këshilluese për fermerët në Kosovë.

PPSE-ja ka punuar me **tre ofrues shërbimesh turizmi** për të përmirësuar shërbimet mbështetëse për këtë sektor. Një shërbim për përgatitje dhe prezantim më të mirë në panairë ndërkombëtare është lehtësuar për pesë NVM, që më pas u ekspozua në panairin ITB Berlin dhe Destination Nature. Kjo rezultoi pozitivisht, ku NVM-të kishin më shumë turistë të huaj përmes prezantimit më të mirë, dhe promovim të marrëveshjeve biznesore me agjenci ndërkombëtare. Përveç kësaj, për të adresuar kërkesën në rritje të sektorit privat për profesione të specializuara, **dy trajnime jo-formale** (guida dhe kamerierë) janë mbështetur nga PPSE. NVM-të priten të punësojnë trajnerë në muajt e ardhshëm.

- Intervenimi për **profesionin e specializimit turistik** ka përfshirë futjen e dy trajnimeve jo-formale, njërin për **guidë turistik** dhe tjetrin për **kamerierë/kameriere**. Përmes vlerësimit të shpejtë me rreth 50 biznese turistike (hotele, bujtina, restorante, operatorë turistikë), PPSE-ja ka kuptuar kërkesat e sektorit privat për guida. Rezultatet e vlerësimit kanë treguar se ka pasur një kërkesë të lartë për guida, dhe që bizneset ishin të gatshme t'i angazhojnë. PPSE-ja ka zbatuar intervenimin në konsultime të afërta me komunat e Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës, duke u bërë partnerë me "Gears-up Solution" për të ofruar trajnime për guida të qyteteve. Trajnimi do të ofrohet në Korrik, me synimin e trajnimit të 30 individëve nga komunat e Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës. Trajnimi i 39 kamerierëve/kameriereve është mbështetur nga fondi për përfshirje sociale, dhe është organizuar për bizneset dhe trajnuesit serbë nga Organizata e Turizmit Graçanica.

## Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes

Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes	Treguesi i të arriturve	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.2.1 Numri i NVM-ve që përdorin kanale të reja dhe të përmirësuara të shitjeve		T=75 NVM A= 37 NVM	49%	300	12%
	OP 2.1.2 Numri i aktiviteteve të përbashkëta promovionale për segmentet e tregut	0	T= 13 A= 6	46%	50	12%

Intervenimet dhe aktivitetet lidhur me qasjen e sektorit të FNI-së në kanalet e shitjes, kanë qenë kryesisht të fokusuara në promovimin e eksporteve. Intervenimi **mbështetje lidhjeve tregtare** është realizuar në bashkëpunim me BMO-në Organikan dhe ka qenë veçanërisht i suksesshëm – që veçse rezultoi me **rritje të eksportit për rreth 1 milion €**. Përmes këtij intervenimi, NVM-të janë mbështetur që të ekspozojnë në Panairin Biofach për herën e parë. Për më shumë, një mision për shitje për NVM-të në Zvicër është organizuar në bashkëpunim me një ndërmarrje Zvicerane, Triple

E,<sup>11</sup> e specializuar në lehtësime tregtare. Ky aktivitet ka ndodhur në Korrik, dhe reagimet fillestare janë shumë pozitive.

NVM-të në sektorin e produkteve pyjore jo-drusore dhe sektorin MAP kanë përfituar nga ky intervenim, ku 8 ndërmarrje kanë përdorur qasje në kanalet tregtare të krijuara përmes dy aktiviteteve të reja promovionale.

- Ndryshe nga Faza I e PPSE-së, ku projekti ka bashkëpunuar me KIESA-n për të lehtësuar pjesëmarrjen në panaire tregtare, gjatë fazës aktuale intervenimi **mbështetje lidhjeve tregtare** ka qenë i lehtësuar përmes BMO-ve të sektorit. Shtatë NVM kanë marrë pjesë në panairin tregtare BioFach në Nuremberg, Gjermani (i organizuar në shkurt të vitit 2018). Ekspozimi në panair është vlerësuar lartë nga NVM-të pjesëmarrëse, duke rezultuar në 9 marrëveshje të krijuara me të hyra me një vlerë eksporti rreth **1 milion €**. Ky aktivitet, ka qenë aktivitet përcjellës ndaj të arriturës 2.1, intervenimit **lehtësimi i programeve certifikuese**, ku kompanive të cilat kanë përfituar nga certifikimi organik u është dhënë një mundësi të shfaqin produktet e tyre në panair tregtar, ku certifikimi organik është kriter kryesor.
- Përveç kësaj, PPSE-ja ka mbështetur nja mision për shitje në Zvicër për 6 NVM (anëtare të Organikas), i cili ka qenë i përgatitur nga Triple E, një ndërmarrje Zvicerane e specializuar në lehtësime tregtare. Misioni ka ndodhur në korrik dhe përbëhej nga katër vizita në ndërmarrjet zvicerane dhe shkëmbimeve biznesore me **12 ndërmarrje zvicerane**. Për shkak të interesimit të lartë të ndërmarrjeve zvicerane, PPSE-ja po planifikon një mision përcjellës me Triple E, për lehtësimin e një vizite në Kosovë për ndërmarrjet zvicerane.

Nën këtë të arritur, sektori i Turizmit ka organizuar **3 udhëtime familjarizuese për tregun aziatik**, mbështetje NVM-ve në ekspozimin e **dy panaireve ndërkombëtare turistike, aktivitete promovuese digjitale të targetuara për NVM-të ITB Berlin dhe DN Paris**, si publikimi në media të specializuara (Wanderlust UK, Swiss Alpine Magazine, dhe më shumë se 15 artikuj të publikuar në revistat dhe gazetatat japoneze dhe koreane të udhëtimit). Promovimi në Azi përfshin një bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Turkish Airlines dhe do të vazhdojë përgjatë vitit.

Në përgjithësi, 29 NVM kanë përdorur në mënyrë të drejtpërdrejt kanale të reja dhe të përmirësuara të shitjeve. Promovimi në panaire ndërkombëtare të turizmit, dhe promovimi digjital veçse ka filluar të jap rezultat, me ç'rast ndërmarrjet përfituese kanë raportuar një rritje prej 210 turistëve ndërkombëtarë dhe rritje të qarkullimit prej €273,00, si rezultat direkt i intervenimeve.

- Nën **intervenimin i promovimit ndërkombëtar**, PPSE-ja ka lehtësuar përgatitjen e pesë operatorëve turistikë për tu promovuar më mirë dhe për të krijuar lidhje biznesore në ITB Berlin dhe DN Paris. Për më shumë, PPSE-ja ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme për të organizuar dy udhëtime familjarizuese me operatorë turistikë dhe dy udhëtime me gazetarë nga Japonia dhe Koreja e Jugut. Turkish Airlines është kontribuuesi kryesor, i cili është zotuar të paguaj të gjitha biletat e pjesëmarrësve për udhëtime turistike familjarizuese/gazetarët. Deri tani, një udhëtim me 7 gazetarë nga Korea e Jugut është organizuar, dhe një udhëtim familjarizues me 8 operatorë turistikë Japonez (i organizuar në korrik). Këto aktivitete janë duke u lehtësuar nga Ambasada e Kosovës në Japoni.

Një udhëtim tjetër familjarizues me operatorë turistikë aziatikë, është organizuar nga Travel Shop Turkey dhe Travel South Albania, i mbështetur nga PPSE-ja dhe operatorët turistikë Veneta Travel dhe Shop Turkey. 52 operatorët turistikë nga Azia Jugore dhe Lindja e Mesme kanë vizituar Kosovën për herën e parë, duke u njoftuar me ofertën lokale për dy ditë në Prishtinë dhe Prizren.

<sup>11</sup> [www.eeexport.com](http://www.eeexport.com)

Një iniciativë tjetër ka qenë përmirësimi i promovimit digjital të ofertës së turizmit të Kosovës, përmes mediave ndërkombëtare të specializuara. Në këtë aspekt, PPSE-ja ka bërë partneritet me BNA-në për të promovuar ofertën në revistën Financial Times, Wanderlust UK dhe revistën Swiss Alpine. Rezultatet tregojnë që 86 turistë kanë qëndruar në Kosovë për një mesatare prej 9.6 ditësh, duke shpenzuar rreth €71,000.

- Nën intervenimin **promovimi shtetëror përmes influencuesve**, PPSE-ja ka bërë partneritet me PriFilm Fest, për të mbështetur dy udhëtime për zbulimin e vendndodhjeve, me 19 regjisorë ndërkombëtar dhe përfaqësues të industrisë së filmit. Qëllimi është promovimi i Kosovës në industrinë ndërkombëtare të filmit, si një vend për film-bërje. Zbulimi i vendeve të xhirimit do të ndodh në korrik, kur mbahet PriFilm Fest.

### Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin

Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2018 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.3 Numri i iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e rrjetëzimit dhe organizimin e sektorit rreth temave të përzgjedhura: menaxhimi i mbeturinave, segmentet e tregut, promovimi, koordinimi dhe shkëmbimi i njohurive	0	T=3 A= 2	67%	10	20%

PPSE po monitoron nga afër zhvillimin e ndryshimeve të pritshme për ligjin e tregtisë së brendshme – vazhdim nga faza e parë. Intervenimet dhe aktivitetet specifike për përmirësimin e organizimit të sektorit të FNI-së, veçanërisht në lidhje me trajtimin e praktikave të padrejta tregtare, janë planifikuar për pjesën e dytë të vitit 2018. Megjithatë, ekipi ka bashkëpunuar ngushtë me BMO-të e sektorit si Organika, Mjedra e Kosovës, Klubin e Prodhuesve lidhur me intervenimet dhe aktivitetet tematike. Është e rëndësishme që bashkëpunimi në këto aktivitete ka kontribuar në rritjen e anëtarësimit dhe ndikimit të BMO-ve të sektorit.

Në sektorin e turizmit, PPSE ka lehtësuar aktivitetet në këtë rezultat me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e koordinimit ndërmjet sektorit publik dhe privat dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të sektorit privat. Pas aktiviteteve të koordinimit dhe iniciativave nga Faza I, PPSE ka mbështetur MTI-në me hartimin e një **propozimi konceptual për themelimin e Organizatës Kombëtare të Turizmit**. Ky propozim u prezantua në Zyrën e Kryeministrit me një grup përfaqësues të operatorëve turistikë. PPSE gjithashtu po e mbështet Komunën e Prishtinës përmes procesit të përgatitjes dhe hartimit të Strategjisë së Turizmit. Kjo po behet përmes përfshirjes aktive e gjithëpërfshirëse të sektorit privat. Një rezultat i menjëhershëm i kësaj iniciative ka qenë vendimi i komunës për të funksionalizuar qendrën e informimit turistik në Prishtinë.

- **Avokimi** për themelimin e **Organizatës Kombëtare të Turizmit** është bërë përmes një koncept propozimi të përgatitur nga një ekspert ndërkombëtar. PPSE ka punuar me disa aktorë të sektorit privat për t'i aftësuar ata që të artikulojnë në mënyrë efektive kërkesat e tyre në Zyrën e Kryeministrit lidhur me rolin e tyre në promovimin e Kosovës si destinacion turistik. Ata kanë avokuar për një përkushtim më të madh financiar për sektorin e turizmit, krijimin e brendit kombëtar, strategjinë sektoriale etj. Qeveria është përgjigjur duke përfshirë elementet kryesore të kërkesave të tyre në draftin e koncept dokumentit për ndryshimin e ligjit ekzistues të turizmit nga MTI, i cili është paraparë për t'u miratuar nga Qeveria. Ndërsa në të njëjtën kohë, MTI-ja filloi procesin e avancimit të Divizionit ekzistues të Turizmit në një

Departament që shpie në ndarjen më të madhe të buxhetit për sektorin e turizmit dhe angazhim të një numri më të madh të stafit.

- PPSE është akorduar që të mbështesë Komunën e Prishtinës për zhvillimin e **strategjisë së turizmit**. Kjo u lehtësua duke aplikuar metodologjinë SGDM (metodologjia e Saint Gallenit për menaxhimin e destinacioneve) me aktorët e turizmit në Prishtinë për identifikimin dhe prioritizimin e rrjedhjeve kryesore të vizitorëve nga perspektiva e ofertës. Gjetjet e analizës së rrjedhës së vizitorëve dhe Anketa në Dalje (ang. Exit Survey) në Prishtinë (2016) janë shfrytëzuar si bazë për hartimin e strategjisë së turizmit të Komunës së Prishtinës. Strategjia pritet të miratohet nga kuvendi komunal në muajt në vijim.
- Për të trajtuar temat rreth **menaxhimit të mbeturinave**, PPSE ka porositur hartimin e një studimi (dokumenti të bardhë; ang. white paper) për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike. Studimi pritet të përfundojë në gusht dhe aktivitetet e mëtejshme të avokimit do të zhvillohen më pas. Për më tepër, ekipi turizmit të PPSE-së vendosi të trajtojë në mënyrë specifike çështjen e mbeturinave ushqimore pasi përbëjnë 50% të mbeturinave dhe kryesisht vijnë nga sektori i mikpritjes (hotelet dhe restorantet). Është kryer një vlerësim i brendshëm i shpejtë për identifikimin e modeleve të proceseve të riciklimit të mbeturinave ushqimore dhe identifikimin e aktorëve lokalë që duhet të jenë pjesë e këtij procesi. Deri në këtë periudhë raportimi, janë identifikuar dy ofrues të mundshëm të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve ushqimore dhe konvertimin e tyre në biogas.

### 3.4.1. Fondi i mundësive

Bazuar në vlerësimin dhe përvojën në Fazën e I-rë , Fondi i Mundësive vazhdoi të përdoret si një instrument shtesë për sektorët. Udhëzuesi operativ i fondit të mundësive është adaptuar në tremujorin e parë të vitit 2018. Mundësitë që plotësojnë intervenimet sektoriale janë duke u identifikuar në mënyrë të vazhdueshme nga lehtësuesit e sektorit, lehtësuesi i minoriteteve dhe menaxheri i fondit të mundësive.

Për të trajtuar problemin e cilësisë së ulët, rendimentin e prodhimit primar dhe për t'iu përgjigjur kërkesës në rritje të sektorit për bujqësinë e kontraktuar, PPSE-ja ka projektuar një intervenim për futjen e prodhuesve të specializuar të farërave të perimeve. Mungesa e fidanishteve të specializuara theksohet të jetë kufizimi kryesor nga të gjithë ekspertët e fushës, përderisa vendet në rajon kanë përjetuar një transformim të sektorit nga futja e këtyre akterëve të tregut.

Prandaj, duke respektuar parimet e fondit të mundësive, kriteret e pranueshmërisë dhe vlerësimit të firmës, në mars të vitit 2018, projekti lëshoi një thirrje për propozim për të themeluar fidanishten e parë të specializuar për prodhimin e farërave të përshtatshme për fushat e hapura, rrjetat dhe serrat. Ishin 13 kompani që shprehën interesin e tyre për aplikimin, ndërsa 7 prej tyre paraqitën koncept dokumentet e tyre. Më pas, 3 kompani ishin përzgjedhur në listë të ngushtë dhe pas vizitës në terren si dhe vlerësimit të propozimeve, ekipi i PPSE-së përzgjodhi kompaninë AGROBORA nga Skenderaj, si partnerin e duhur për këtë bashkëinvestim. Kompania Peppermint International, e cila gjendet në pjesën veriore të Kosovës të banuar nga komuniteti i pakicës serbe, poashtu u përzgjodh për bashkëfinancim nga fondi i mundësive, për rritjen e kapaciteteve prodhuese të vajrave esenciale, përmirësimin e farërave dhe prodhimtarinë e bimëve medicinale aromatike si dhe rritjen e prodhimit të kontraktuar. Marrëveshja e tretë bashkë-investuese u nënshkrua me Produkte Natyrale të Kosovës nga Komuna e Pejës. Projekti ka për qëllim të rrisë kapacitetet e përpunimit të kompanisë për kulturat e reja si kungulli, luledielli dhe kultura të tjera që kanë kërkesa të larta për tregun vendor dhe për eksport, si dhe rritjen e prodhimit primar përmes bujqësisë së kontraktuar me partnerë të rinj në rajone të reja për kultivim.

Fondi i mundësive do të vazhdojë të nxisë risi në një fushë të caktuar përderisa në lidhje me objektivat e projektit mund të organizohet një thirrje specifike tematike.



### 3.4.2. Fondi për Përfshirjen Sociale

Brenda periudhës raportuese, SDC (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ang. Swiss Agency for Development and Cooperation;) ka miratuar tre kërkesa në kuadër të Fondit për Përfshirje Sociale (ang. SIF – Social Inclusion Fund).

Ndërhyrja e parë e SIF-it paraqet pilotimin e një intervenim të trefishtë në Komunën e Graçanicës, që synon rritjen e të ardhurave për grupet e margjinalizuara dhe përmirësimin e operacioneve me materialet e riciklimit të mbeturinave komunale dhe veprimtarinë tregtare me sektorin privat: (1) PPSE ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me kompaninë për grumbullimin e mbeturinave, G-PLUS doo, në maj të vitit 2018. Nëpërmjet këtij partneriteti, PPSE ka mbështetur përmirësimin e kapaciteteve përpunuese të kompanisë, e cila do të çojë në krijimin e 6 vendeve të reja të punës për punonjësit romë brenda objektit dhe do të rris qasjen në pika të shitjes për 32 familje rome të angazhuara në grumbullimin e mbeturinave. (2) Në shtator të vitit 2018, do të nënshkruhet një Memorandum i Mirëkuptimit me Komunën e Graçanicës, për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe për të bërë që peizazhi komunal të jetë më tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj. PPSE do të mbështesë blerjen e shportave ndarëse për 177 familje, ndërsa komuna do të fillojë fushatën vetëdijësuese për rëndësinë e riciklimit. (3) Pas trajnimit të lartpërmendur, për të rritur efikasitetin e punës, PPSE do të shpërblejë 3 përpunues të vegjël nga komuniteti rom me makineri shtypëse për mbeturinat e riciklueshme. Ky aktivitet është planifikuar për shtator të vitit 2018.

Marrëveshja e dytë e partneritetit të FPS-së është nënshkruar me Organizatën e Turizmit Gračanica (TOG) në maj 2018. TOG ka zbatuar 2 trajnime afatshkurtra për kamarierë / kamariere, siç shpjegohet në paragrafin 2.1.

Intervenimi i tretë e miratuar i SIF është aktiviteti i përbashkët me projektin për Përmirësimin e Punësimit të Rinjve (EYE; ang. Enhancing Youth Employment EYE), Helvetas, për të mbështetur OJQ-në LEAP që të kryej një studim mbi stereotipet gjinore dhe zgjedhjet arsimore në Kosovë. Në korrik, të dy projektet nënshkruan marrëveshjen e partneritetit me OJQ-në LEAP, duke synuar përdorimin e hulumtimit akademik për rritjen e vetëdijësimit, që në fund do të ndihmonte kompanitë për të kuptuar burimet njerëzore nga perspektiva gjinore.

Në fillim të vitit 2018, së bashku me projektin EYE, PPSE-ja ka bërë një analizë lidhur me statusin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE) në Kosovë dhe mundësitë e ardhshme. Ne kemi vlerësuar dhe kadastruar bizneset RAE, palët e interesit dhe nën-sektorët e mundshëm ku komuniteti RAE është më aktiv në Kosovë.

## 4. Temat transversale

### 4.1. Përfshirja Sociale

Pjesët e mëposhtme përfaqësojnë integrimin e pakicave në intervenimet e sektorit të UPN-së dhe sektorit të turizmit për këtë periudhë raportuese.

#### **Përfshirja e pakicave në intervenimet e FNI-së:**

- Nën marrëveshjet e partneritetit të FNI-së në intervenimin **Përforsimi i sistemit bujqësor të kontraktuar** ka rreth 30 fermerë (kryesisht pakicë serbe) ose 10% të numrit të përgjithshëm të përfituesve. Për më tepër, projekti i fondit të mundësive me biznesin Peppermint (me adresë në Leposaviq) synon përmirësimin e kapaciteteve operacionale dhe ngritjen e fidanishteve të specializuara për prodhimin e farërave të MAP-it, e cila është e para në pjesën veriore të Kosovës. Fillimisht, 26 fermerë do të përfitojnë falas farëra për kultivimin e MAP-it, të cilat bëjnë pjesë në intervenimin e bujqësisë së kontraktuar dhe prodhimi i tyre do të përdoret si lëndë e parë për nevojat e kompanive për përpunimin e vajrave esenciale.

- Në kuadër të misionit SEC në Kosovë, 2 biznese minoritare kanë nënshkruar marrëveshjet, një për përmirësimin e shitjeve dhe shërbimeve të marketingut dhe tjetrën për përmirësimin e recetave dhe cilësisë së produktit.

**Përfshirja e pakicave në intervenimet e turizmit:**

- Në kuadër të intervenimit për zhvillimin e produkteve të turizmit, PPSE-ja ka përfshirë dy komuna minoritare, Zubin Potok dhe Leposaviq, në vlerësimin për mundësitë e zhvillimit të produkteve të turizmit (kryer nga MDP - kompani franceze). Raporti përshkruan mundësitë e përshtatshme për zhvillimin e produkteve të turizmit që mund të tërheqin investime potenciale të sektorit privat dhe publik.
- Në kuadër të anketës së ofertës së turizmit, bizneset në pronësi të minoriteteve në Shtërpçë, Graçanicë dhe komuna veriore do të jenë pjesë e vlerësimit vjetor.

## 4.2. Gjinia

### Përfshirja e grave në intervenimet FNI-së

Brenda sektorit të FNI-së, 7 nga 19 partnerë përfaqësohen nga gratë, konkretisht: 99 Lule, Biofruti, Krusha CoOp, Bliff, R Company, Trboljevac dhe Vicianum. Për më tepër, nëpërmjet partnerëve tanë, kryesisht sipas intervenimit të bujqësisë kontraktuese, përfshirja e grave është siguruar si në kontraktimin e fermerëve në mënyrë të drejtpërdrejtë (nga 234 fermerë të kontraktuar, 90 janë femra) ashtu edhe në kontraktimin e punëtorëve (më shumë se 40%).

- Aktivitetet dhe mekanizmat që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe shumë llojllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve përfshijnë 28 kompani, nga të cilat 8 janë në pronësi, në bashkëpronësi ose menaxhohen nga gratë. Përveç kësaj, projekti ka mbështetur nisjen e Shëtitjeve Globale të Mentorimit në Kosovë, në total me 100 gra. Kjo është një iniciativë globale për mentorim që synon gratë sipërmarrëse, e cila është mbajtur për herë të parë në Kosovë. Qëllimi i kësaj iniciative të mentorimit është që të mundësojë transferimin e njohurive dhe shkathtësive nga një grua sipërmarrëse (mentore) me përvojë, tek një grua tjetër që aspiron të bëhet një sipërmarrëse/menaxhere e suksesshme (e mentoruar).
- Në kuadër të marrëveshjeve të partneritetit të bujqësisë kontraktuese të cilat janë nënshkruar me përpunuesit, qendrat grumbulluese dhe fidanishtet, 3 nga 9 partnerë të NVM-ve janë në pronësi ose në bashkëpronësi të grave.
- Dy NVM-të me pronësi të grave janë gjithashtu pjesë e mbështetjes së certifikimit organik dhe Global GAP.

### Përfshirja e grave në intervenimet e turizmit

- Deri në periudhën raportuese, në sektorin e turizmit angazhimi i grave është siguruar nëpërmjet ndërhyrjes në profesione të specializuara të turizmit, posaçërisht duke synuar që numri i barabartë i grave dhe burrave të trajnohen si guida të qytetit. 50% e pjesëmarrësve janë gra.
- Bizneset e turizmit të cilat janë promovuar ndërkombëtarisht përmes intervenimit ndërkombëtar të promovimit, kanë raportuar angazhimin e dy guida femra, nga gjithsej shtatë sosh në aktivitetet e tyre.
- Përveç kësaj, ekipi i turizmit i PPSE-së ka lehtësuar procesin e qasjes në kanalet e reja të shitjeve për bizneset në pronësi të grave përmes aktivitetit në vijim:
  - Strehimorja - Pylli i arinjve (përfitues potencial i fondit të mundësive) – ka rregulluar një stendë për një biznes në pronësi të grave, për të shitur dhe ekspozuar produktet në dyqanin e tyre.

### 7.2.2. Monitorimi dhe matja e rezultateve

Puna e MRM-së në këtë gjashtëmuor është fokusuar në hartimin e dokumenteve për intervenim për fazën e II-të. Ekipet fillimisht kanë zhvilluar zinxhirët e rezultateve sektoriale për dy sektorët, një për turizmin dhe një tjetër për FNI-në, të cilat janë përdorur rregullisht për monitorimin e progresit dhe ndryshimet sistematike.

Zinxhirët e rezultateve janë zhvilluar gjithashtu për të gjitha ndërhyrjet e vazhdueshme për sektorët e tjerë. PPSE gjithashtu do të fillojë së përdoruri një formë të përditësuar (të integruar në Visio) të planeve të ndërhyrjes së MRM-së. Në muajin tetor, PPSE planifikon të fillojë vlerësimet e ndikimit për të gjitha intervenimet, në përputhje me fundin e sezonit / ciklit në sektorin e turizmit dhe atë të FNI-së. Rrjedhimisht, rezultatet e validuara për intervenimet e vitit 2018 do të paraqiten në raportin e fundvitit 2018 të PPSE-së .

PPSE është duke kryer dy studime, njëri studim është anketa e ofertës turistike dhe tjetri është lidhur me ndikimin e përdorimit të farërave të perimeve në prodhim (të kultivuara nga fidanishtet profesionale / gjysmë profesionale). Anketa e ofertës turistike aktualisht është duke u kryer. Në krahasim me fazën e I-rë, ky studim do të mostrohet në atë formë që të përfshijë të gjitha ndërmarrjet e lidhura me turizmin në tërë Kosovën.

Anketa është planifikuar të zhvillohet çdo vit, fillimisht për të kuptuar ndikimin e të ardhurave dhe punësimit të sektorit të turizmit në mbarë Kosovën dhe më pas të monitorojë ndryshimet vjetore. Të gjeturat e sondazhit gjithashtu do të shfrytëzohen për të përcaktuar matësin e përafërt të punësimit (të përdorur në fazën e I-rë), bazuar në shpenzimet e turizmit, për vlerësimin e ndikimit në punësim që mund t'i atribuohet projektit.

Studimi i prodhimit të fidanëve është duke u zhvilluar me një grup fermerësh të përfshirë në ndërhyrjen bujqësisë së kontraktuar në sektorin e FNI-së që janë të lidhur me një prodhues ekzistues gjysmë profesional të fidanëve. Në bashkëpunim me partnerin e intervenimit, janë duke u monitoruar dy grupe fermerësh – njëri grup i cili ka marrë farëra nga një prodhues ekzistues gjysmë profesional dhe një tjetër i cili ka prodhuar vet farëra (përmes metodave tradicionale). Përmes kësaj, ekipi po përpiqet të përcaktoj ndikimin e përdorimit të farërave të prodhuara nga fidanishtet profesionale. Më pas, të gjeturat mund të shfrytëzohen për të matur ndikimin e intervenimit dhe investimin e fondit të mundësive për futjen e prodhuesve të specializuara të farërave.

Siç u përmend më lart, metodologjia e PPSE-së për matësin e përafërt të turizmit dhe shumëfishuesit është përzgjedhur dhe më pas është paraqitur nga specialisti i MRM-së në punëtorinë globale DCED-BEAM në Nairobi, Kenia.

### 7.3 Komunikimi

Në gjashtë muajt e parë të fazës II, PPSE është përpjekur të komunikojë ndikimin e mbështetjes zvicerane përmes një shumëllojshmërie të kanaleve dhe mediave.

**Ngjarjet:** Më 1 mars 2018, PPSE organizoi ngjarjen e lansimit të fazës së II-të. Ngjarja u zyrtarizua nga ambasadori zviceran në Kosovë dhe zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, ndër të tjerë, me rreth 200 pjesëmarrës nga sektori privat dhe publik, organizatat e donatorëve si dhe mediat.

Ngjarja shërbeu si një platformë për të shfaqur rezultate konkrete dhe arritje nga faza e I-rë dhe për të prezantuar rrugën përpara në fazën e II-të. Ngjarja është mbuluar shumë mirë nga mediat.

Më 22 prill 2018, PPSE shënoi Ditën Ndërkombëtare të Tokës me një iniciativë të komunitetit për të rritur vetëdijësimin për mbajtjen e një ambienti më të pastër, riciklimin dhe mbjelljen e pemëve, në mbështetje të aktiviteteve të zhvillimit të turizmit. Pas konsultimeve me ekipin e PPSE-së, ideja është përfaqëuar nga Komuna e Prishtinës, e cila rezultoi me përfshirjen e entiteteve komunale,

Universitetit të Prishtinës, sektorit privat dhe OJQ-ve për t'u bashkuar me aktivitete të ndryshme me programin e ditës. Ngjarja kishte një mbulim të gjerë të medias dhe roli i PPSE si iniciator është evidentuar sa duhet.

Këtë vit, PPSE dhe departamenti i komunikimeve në zyrën qendrore të Swisscontact, ofruan përkrahje për Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës përmes promovimit në internet dhe media për prodhuesit e sektorit të drurit të Kosovës duke i ekspozuar në panairin Swissbau në Basel.

Përfituesve të projektit dhe institucioneve partnere sipas nevojës, u është ofruar ndihma lidhur me marrëdhëniet me publikun dhe komunikimet, p.sh. me gjenerimin e lajmeve në media, hartimin e njoftimeve për shtyp dhe koordinimin e ngjarjeve.

**Mediat sociale dhe prezenca online:** Në periudhën raportuese, PPSE lansoi projektin për faqen e re të internetit, e cila është në përputhje me projektin e fazës së II-të të projektit, është më i përshtatshëm për përdoruesit, mund të përdoret në paisje telefonike, dhe me funksione tjera ta shtuara. Faqja e PPSE-së është përditësuar plotësisht në webfaqen e internetit të Swisscontact në të gjithë botën, për të pasqyruar aktivitetet e fazës së II-të dhe për të shfaqur rezultatet e fazës së I-rë.

Faqja në Facebook e PPSE-së ishte mjeti kryesor i komunikimit online të projektit. Numri total i shtrirjes (numri i përdoruesve unikë, pëlqyes apo jo të faqes, të cilët i kanë parë postimet në faqe) në periudhën raportuese ishin 119,276. Postimet tona janë shpërndarë nga faqja zyrtare e Ambasadës së Zvicrës në Facebook; Swisscontact mbarë botëror; grupi i partnerëve zbatues të SDC, si dhe faqet partnere ose individuale.

Gjithashtu, PPSE ka hapur një llogari në Twitter për të testuar edhe në këtë platformë. PPSE përdorë një llogari medium.com për të publikuar artikuj më të gjatë, të cilat më pas merren nga mediat lokale. Anëtarët e ekipit përdorin llogaritë personale të LinkedIn për të shpërndarë më tej lajmet e projektit.

**Publikimet dhe Videot:** PPSE ka publikuar si më poshtë: një dokument një faqesh dhe një broshurë sqaruese lidhur me shërbimet e Trupave të Ekspertëve Seniorë. PPSE ka zhvilluar një video për të nxjerrë në pah aktivitetet e fazës së I-rë dhe për të përmbledhur rezultatet, si dhe një video mbi një produkt të ri turistik.

**Raportimi në media:** Në periudhën raportuese, PPSE dhe aktivitetet e përfituesve tanë kanë marrë mbulim të mirë të medias përmes: artikujve të botuar në agjencitë online të lajmeve rreth aktiviteteve të financuara nga SDC përmes PPSE-së; radio dhe intervista televizive me anëtarët e ekipit të PPSE-së dhe përfituesit; raporte televizive mbi aktivitetet specifike të PPSE-së p.sh. prezantimi i fondit të mundësive, vizita e gazetarëve të Koresë së Jugut në Kosovë, apo artikuj të botuar fillimisht nga PPSE dhe më pas të mbledhura nga mediat lokale. Shih Shtojcën V për një listë me citimet dhe paraqitjet mediale të PPSE-së, Swisscontact-it dhe SDC-së.

**Pajtueshmëria dhe dukshmëria:** Të gjitha materialet e komunikimit të PPSE-së ndjekin udhëzimet e shënjitimit dhe komunikimit të SDC-së. Çdo gjë është botuar në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

## 8. Mësimet e nxjerra

Bazuar në përvojën e kësaj periudhe raportuese, PPSE ka identifikuar disa mësimet specifike të lidhura me rezultatet, të cilat do të përdoren për udhëheqjen dhe përmirësimin e zbatimit përgjatë fazës II.

- Pas përvojës së fazës I të zhvillimit të produkteve të turizmit në rajonin e Pejës, ekipi priste një reagim më të lartë të sektorit privat për të investuar në produktet e turizmit. Përkundër

kësaj pritjeje, kishte pak interes nga sektori privat për të investuar në produktet e turizmit, veçanërisht në rajonet e Prishtinës dhe Prizrenit. Megjithatë, përgjigja e këtyre dy komunave ka qenë shumë pozitive, ku disa projekte / atraksione të mëdha turistike janë në planifikim dhe implementim. Mësim i nxjerrë nga kjo është se në komunat e mëdha si Prishtina, potenciali për shfrytëzimin e fondeve publike ose partneritete publike-private për të zhvilluar produkte të mëdha turistike është i lartë dhe në raste të tilla PPSE duhet të shërbejë më shumë si një lehtësues për ekspertizën teknike dhe shkëmbimin e njohurive.

- Në periudhën raportuese, përkrahja promociionale u organizua më shumë nëpërmjet shoqatave dhe ambasadave. Kjo është bërë për shkak të një motivimi më të madh të anëtarëve të shoqatës dhe aktorëve të tjerë për të organizuar aktivitete të fokusuar, siç janë panairt tregtare. Një shembull i tillë është ai i Biofach Fair. Kjo doli shumë e suksesshme, me më shumë pronësi nga bizneset kur shoqatat e sektorit organizojnë aktivitete promovuese.
- Qëndrueshmëria e shoqatave të sektorit mbetet e brishtë. Modelet aktuale të financimit të shoqatave të sektorit (siç është Organika) varen nga mbështetja e donatorëve (USAID). Megjithatë, aktivitetet e tyre janë të suksesshme përderisa anëtarët përfitojnë drejtpërdrejt. PPSE do të vazhdojë të mbështesë këto shoqata të sektorit me aktivitete që përputhen me strategjinë dhe intervenimet e PPSE-së. Një shoqatë aktive që ofron përfitime për anëtarët e saj mund të jetë një mekanizëm i fuqishëm për të fituar mbështetjen e anëtarëve, e cila mbështetje është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë.
- Përfshirja e bizneseve në pronësi të grave në të gjitha intervenimet është e ulët. Kjo për shkak të nivelit të ulët të bizneseve në pronësi të grave në Kosovë. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore është e kënaqshme në të gjitha intervenimet. Për të rritur fuqizimin e gruas, PPSE ka zbatuar intervenime të shënjestruara. Në nivelin të bujqësisë, kjo është veçanërisht e vlefshme për sektorin bimëve medicinale dhe aromatike. Ekipi po kërkon gjithashtu mundësi për të punuar në sektorin e konditorive, ku ka më shumë biznese në pronësi të grave.
- Mungesa e shërbimeve dhe ekspertizës së teknologjisë ushqimore mbetet një nga sfidat kryesore në sektorin e përpunimit të ushqimit. Ekipi ka mësuar se një zgjidhje gjithëpërfshirëse sektoriale është komplekse dhe gati e pamundur. Prandaj, qasja duhet të jetë më specifike për kompanitë individualisht. PPSE po zbaton dhe planifikon qasje të përshtatura për NVM-të përmes ekspertëve të SEC-ut, intervenimet e trajnimit për rritje, etj.
- Rreziqet e bujqësisë nga kushtet klimatike mbeten të dukshme. Kjo ka qenë veçanërisht e rëndësishme këtë vit, ku një sasi e konsiderueshme prodhimi të perimeve është dëmtuar. Kjo përsëri thekson nevojën për skemën e sigurimit të kulturave bujqësore. Megjithatë, futja e skemës së sigurimit të kulturave bujqësore kërkon një qasje kolektive nga sektori publik, sektori privat dhe komuniteti i donatorëve. PPSE do të vazhdojë të ndjekë dhe të marrë pjesë në diskutimin lidhur me zhvillimin e skemës së sigurimit të kulturave bujqësore nga IFC dhe MBPZHR.
- Mundësitë për përfshirjen e grupeve minoritare dhe grupeve të cenuara në të dy sektorët janë të kufizuara. Prandaj, në mënyrë që të shënjestrohet veçanërisht komunitetin RAE, intervenimet duhet që të fokusohen në sektorë të ndërlidhur siç është menaxhimi i mbeturinave.